



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/11
Datë: 15.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 89 të Ligjit Nr. 04/1-125 për Shëndetësi dhe në zbatim të nenit 41 të Ligjit Nr. 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2020 nxjerr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen emergjencës për shëndetin publik

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë që Qeveria e Republikës së Kosovës shpall emergjencë për shëndetin publik.
2. Obligohen Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të veprojnë konform Planit të reagimit kombëtar dhe aktivizimi i funksionit mbështetës emergjent 8 (FME8 shëndeti publik dhe shërbimet mjekësore).
3. Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për menaxhimin e situatës së shpallur të emergjencës për shëndetin publik.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë